



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 50 prot.

Kamëz, më 19.04.2022

V E N D I M

Nr. 43 Datë 19/04 2022

MBI

**“ MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË BONUS QERAJE
BANESAT E TË CILËVE PREKEN NGA RITJA E NIVELIT TE UJËMBLEDHËSIT
TË PASKUQANIT ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.04.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.40 Datë 13.04.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, ligjit nr. 22/2018 për Strehimin Social, ligjit nr. 45/2019 për Mbrojtjen Civile, VKBnr.132 dt.22.12.2021 " Për miratimin e buxhetit për vitet 2022,2023,2024 " VKB nr.119 dt.17.12.2021 " Pë rmiratimin e vlerës së qerasë në treg të lirë për vitin 2022 " Kërkesës nr. 1991 prot. datë 04.03.2021 të Njesisë Administrative Paskuqan, Shkresës nr.1991/1 Prot datë 04.03.2021 të Drejtorisë së Projekteve dhe Investimeve , Urdhërit të Kryetarit nr. 243 datë 10.03.2022, " Për ngritjen e grupit të punës, që do të identifikojë banesat të cilat preken nga rritja e nivelit të ujëmbledhësit të Liqenit të Paskuqanit ", **Këshilli Bashkiak Kamëz** ”;

V E N D O S I:

1. Listën e familjeve që do të trajtohen me bonus qeraje, për shkak se banesat e tyre preken nga rritja e nivelit të ujëmbledhësit të Paskuqanit.
2. Lista e familjeve përfituese është pjesë e aneksit të këtij vendimi.
3. Fondi do të mbulohet nga Buxheti i Bashkisë për vitin 2022 i planifikuar në strukturën Buxhetore Gr.0,Prog 6180 Art.606
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI

